

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush është Gazim Bregu që ndërtoi vilën e Ahmetajt në Hamallaj, përfitoi 20 milionë euro nga rindërtimi, aferat e pandëshkuar e Tigrin 23 milionë euro me Albtelekom
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/25/kush-eshte-gazim-bregu-qe-ndertoi-vilen-e-ahmetajt-ne-hamallaj-perfitoi-20-milione-euro-nga-rindertimi-aferat-e-pandeshtkuar-e-tigrin-23-milion-e-euro-me-albtelekom/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 10:05:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 10:02:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1d4779d7d5a7eb10e521351dd4ae7080ec801d67a8b06fe5ab41df90dc87d3b8
TEKSTI	5c2691d91221915408f7453dd866b934774f77d26ba383eade050dccc389d842
PAMJA	3d933b9cf779b9d290a9cb6a40cdabd6e002aaee423f53b01539f7632ff090c5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e24c843eb423da191fc6a20e00c3b16a5268a65476e1ef166137e91849d9ae86
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5232afb02d0ef3cfba4c89fffc05e27ccc8e2122c3335e6361f8bbb2dc579865
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e24c843eb423da191fc6a20e00c3b16a5268a65476e1ef166137e91849d9ae86>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kush është Gazim Bregu që ndërtoi vilën e Ahmetajt në Hamallaj, përfitoi 20 milionë euro nga rindërtimi, aferat e pandëshkuar e Tigris 23 milionë euro me Albtelekom

Investigim

Publikuar: 25/09/2026



Ish zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj, i cili ka shpenzuar qindra mijëra euro në kazinotë e Evropës, para me burim korrupsionin dhe të padeklaruar në ILDKPKI, është përfshirë në një aferë korruptive edhe me biznesmenin Gazim Bregu, duke përdorur pushtetin për t'u pasuruar dhe devijuar fondet publike në xhepat e klientëve.

Afera korruptive është konstatuar nga SPAK, por megjithatë ende nuk është zbatuar legjislacioni penal ndaj Gazim Bregut, i cili ka përfituar 20 milionë euro nga fondet e rindërtimit, me ndërhyrjen e Arben Ahmetajt, pasi Bregu po i ndërtonte Ahmetajt vilën e famshme në Hamallaj, sekuestruar nga SPAK.

Me të lexuarat

Video /



Kryeagjentja Vlora Hyseni 'i fik radarin' zonjës Pretenca: Je shpirt i keq'



Kryesplunia Vlora Hyseni filmoi politikanë dhe magjistratë me dashnorët në hotel për men mandatin e radhës, përmbaruesit privatë i besojnë sërish drejtimin e DATAT



arrestua në Rusi, zbulohet portreti i Shpëtim Aliut! 'Kumbari' që furnizonte...



Çfarë rrezikon Vlora Hyseni, nëse provohen akuzat e SPAK ndaj saj?

Më konkretisht, Gazim Bregu është themelues dhe pronar i kompanisë së ndërtimit Egeu Stone shpk. Përmes kompanisë Egeu Stone, Bregu ka ndërtuar vilën e Arben Ahmetajt, me numër B22, në Valamar, Hamallaj, vilë të cilën sipas SPAK Ahmetaj e ka kamufluar në emrin e Klodian Zotos, më pas të Geri Kukes dhe në fund në emrin e Erjola Hoxhës, bashkëjetueses së tij.

Biznesmeni Bregu është kontraktuar për të kryer punime shtesë dhe rikostruktuar vilën në fund të vitit 2020, por punimet kanë nisur në mars të vitit 2021. Bregu është kontraktuar nga bashkëjetuesja e Tigrir, Erjola Hoxha dhe motra e tij Brunilda Mene, gjithnjë nën kujdesin e Ahmetajt. Fillimisht Gazim Bregu ka gënjyer në SPAK, por kur është pyetur sërish ka ndryshuar thëniet, duke pranuar se ishte kontraktuar për rikonstruksionin e vilës së Ahmetajt.

Ndërkaq, në një kohë kur po ndërhynte në vilën e Ahmetajt, Gazim Bregu ka nisur të marrë fonde nga programi i rindërtimit. Gjatë kësaj kohe Arben Ahmetaj ishte ministër i Rindërtimit. Gazim Bregu ka marrë rreth 20 milionë euro tendera nga rindërtimi. Edhe pse tenderat janë dhënë nga bashkitë, Ahmetaj diktonte kryesisht fituesit e tyre si ministër i Rindërtimit, i caktuar nga Edi Rama.

Në dosjen e SPAK thuhet se suksesi i Gazim Bregut në tenderat e rindërtimit ka ardhur për shkak të lidhjes me Arben Ahmetajn.

Afera 23 milionë euro me Albtelekom

Është e njohur tashmë historia e korrupsionit të Ahmetajt me Albtelekom, ku vodhi 23 milionë euro. Kjo aferë është mbyllur në vitin 2016 me një tjetër aferë flagrante, e cila nuk është hetuar nga SPAK-u.

Në vitin 2016, Albtelekomi i blerë nga turqit befas u tërhoq nga procesi gjyqësor, ku i kërkonte kompanisë Hermes të Ahmetajt 23 milionë euro, që i kishte vjedhur në vitin 2002 me impulset telefonike. Kur Albtelekom u tërhoq, Ahmetaj ishte ministër i Financave. Ministria e Financave ka rreth 14 % të aksioneve të Albtelekom.

Pra, Ahmetaj në krye të ministrisë që kishte aksione të Albtelekom, tërhiqet nga gjyqi për interesa të kompanisë së tij private, kaluar në emrin e një oligakeje. Jo vetëm kaq. Por, Ahmetaj kishte edhe bashkëjetuesen, Erjola Hoxha, drejtoreshë kyçe tek Albtelekom. Është pikërisht bashkëjetuesja, në emrin e të cilës Ahmetaj fshehu vilën që i dha Klodian Zoto me vlerë 1 milionë në Hamallaj.

TAG:

23 milione euro

Arben ahmetaj

Gazim bregu

Hermes

Hetime

Rindertimi

Spak

Vila ne hamallaj

Të ngjashme



Dyshohet se përvetësoi 69 mln lekë, Gjykata zbut masën për ish-drejtoreshën e Postës



Kërcënoi një grua me foto nudo dhe i mori 15 mijë euro, shqiptari përfundon në polici në Rodos



Murrizi: Dumani pinte kafe çdo të hënë me Vlorën, në qershor 2025 e përzuri nga zyra

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU](#) [INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.